


UDHËZUES PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE NË KONTEKSTIN E FUSHATAVE ZGJEDHORE



**KOMISIONERI PËR
TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE**



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**

PËRMBAJTJA

| | |
|---|----|
| 1. HYRJE | 5 |
| 2. PËRKUFIZIME | 7 |
| 3. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE NË KONTEKSTIN E FUSHATAVE ZGJEDHORE | 9 |
| 3.1 Legjitimiteti i përpunimit të të dhënave personale | 9 |
| 3.2 Përpunimi i të dhënave sensitive në lidhje me mendimet politike. | 13 |
| 3.3 Siguria e të dhënave personale në kontekstin e fushatave zgjedhore | 15 |
| 3.4 Transparenca e përpunimit të të dhënave personale në kontekstin e fushatave zgjedhore..... | 16 |
| 4. TË DREJTAT E ZGJEDHËSVE DHE DETYRIMET E SUBJEKTEVE ZGJEDHORE. | 18 |
| 4.1 Të drejtat e zgjedhësve..... | 18 |
| 4.2 Detyrimet e subjekteve zgjedhore | 19 |

1. HYRJE

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “*Zyra e Komisionerit*”), harton Udhëzuesin “*Për përpunimin e të dhënave personale në kontekstin e fushatave zgjedhore*”, i cili synon të orientojë subjektet zgjedhore mbi mënyrën se si të garantojnë mbrojtjen e të dhënave personale të votuesve gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Ky udhëzues mbështetet në legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE) dhe Këshillit të Evropës (KiE), praktikën ndërkombëtare, si dhe legjislacionin kombëtar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Gjatë fushatës zgjedhore, subjektet zgjedhore, vetë apo nëpërmjet palëve të treta të autorizuar prej tyre, përpunojnë të dhëna personale të zgjedhësve. Në ditët e sotme, për shkak se zgjedhjet po orientohen gjithnjë e më shumë nga të dhënat, është e domosdoshme që përpunimi i të dhënave personale të zgjedhësve të kryhet në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave.

Gjithashtu, për shkak të zhvillimeve teknologjike, po vihen në përdorim gjithnjë e më shumë teknologjitë digjitale dhe mjetet e komunikimit bashkëkohor. Kjo mundëson që subjektet zgjedhore të “*profilizojnë*” zgjedhësit me saktësi gjithnjë e më të lartë e të dërgojnë mesazhe të “*shënjestruara*” nëpërmjet mjeteve të ndryshme të komunikimit duke ndikuar në bindjet e tyre politike.

Për rrjedhojë, zbatimi i parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale ndihmon në përforcimin e integritetit të zgjedhjeve dhe ruajtjes së besimit tek proceset demokratike në epokën digjitale. Përpunimi i paligjshëm i të dhënave personale që zbulon mendimet politike, mund të pengojë dialogun politik dhe ndikon negativisht tek e drejta e shprehjes së lirë politike.

Në këtë kontekst, duke marrë parasysh rreziqet e mundshme që mund të sjellë përpunimi i paligjshëm i të dhënave personale të zgjedhësve, Zyra e Komisionerit inkurajon të gjithë subjektet zgjedhore të zbatojnë parimet e mbrojtjes së të dhënave personale në veprimtarinë e tyre përpunuese gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

2. PËRKUFIZIME

1. *“Fushatë zgjedhore”* nënkupton një tërësi të strukturuar aktivitetesh organizative dhe komunikimi që kryhen nga subjektet zgjedhore të cilat synojnë të ndikojnë përzgjedhjet politike të votuesve.
2. *“Marketing i drejtpërdrejtë”* nënkupton çdo formë komunikimi, përfshirë postën, postën elektronike, mesazhet telefonike/zanore, telefonin apo telefonatat automatike dhe nëpërmjet platformave sociale për qëllime politike.
3. *“Lista e zgjedhësve”* ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.” (në vijim “Kodi Zgjedhor”).
4. *“Përpunues të të dhënave në fushata zgjedhore”* nënkupton çdo person fizik ose juridik të tillë si: furnizues shërbimi, çdo ofrues që kryhen sondazhe politike, marketing të drejtpërdrejtë, analizimin e elektoratit, menaxhim të platformave të rrjeteve sociale, ofruesit e pajisjeve apo programeve kompjuterike të fushatave etj., i cili hyn në një marrëdhënie kontraktore me kontrolluesin me qëllim përpunimin e të dhënave personale të zgjedhësve për llogari të tij.
5. *“Profilizim”* është çdo formë e përpunimit të automatizuar e të dhënave personale që konsiston në përdorimin e të dhënave për të vlerësuar aspekte të caktuara që lidhen me një person fizik, veçanërisht për të analizuar ose parashikuar aspekte

në lidhje me performancën në punë, gjendjen ekonomike, shëndetin, preferencat personale, interesat, besueshmërinë, sjelljen, vendndodhjen ose lëvizjet e tij.

6. *“Profili i zgjedhësit”* është rezultati i zbatimit të teknikave të profilizimit tek votuesit apo votuesit e mundshëm, sidomos për të analizuar apo parashikuar mendimet politike të personit dhe gjasat që ai/ajo të votojë për një parti apo për një tjetër.
7. *“Subjekte zgjedhore”* në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave, janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me Kodin Zgjedhor.
8. *“Zgjedhës”* në cilësinë e subjektit të të dhënave, është çdo person fizik që jep të dhëna subjekteve zgjedhore për llogari të fushatës zgjedhore.
9. *“Të dhëna personale që zbulojnë mendimet politike”* nënkuptojnë një kategori të veçantë të dhënash që zbulojnë aderimin në një ideologji apo doktrinë politike, përkatësi politike apo anëtarësim në parti politike, opinion në lidhje me preferencën e një politike të caktuar dhe/ose bindjet apo lidhjet politike të nxjerra si rezultat i një parashikimi apo konkluzioni.

3. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE NË KONTEKSTIN E FUSHATAVE ZGJEDHORE

3.1 Legjitimiteti i përpunimit të të dhënave personale

Përpunimi i të dhënave personale të zgjedhësve gjatë fushatës zgjedhore në përputhje me kriteret dhe parimet e mbrojtjes së të dhënave të përcaktuara në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar të fushës, është thelbësor për garantimin e ushtrimit të një të drejte tjetër kushtetuese, siç është e drejta e votës.

Përpunimi i të dhënave personale duhet të jetë proporcional me qëllimin legjitim të fushatës zgjedhore dhe t'i kushtojë vëmendje të drejtave dhe lirive të përfshira. Mbledhja e të dhënave personale në lidhje me mendimet dhe preferencat e zgjedhësve, duhet të jetë në përputhje me këtë qëllim dhe nuk duhet të shkaktojë ndërhyrje jo proporcionale tek interesat, të drejtat dhe liritë e zgjedhësve.

Sipas nenit 78 të Kodit Zgjedhor, çdo subjekt zgjedhor, ka të drejtë të bëjë propagandë zgjedhore në çdo mënyrë të ligjshme gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Qëllimi legjitim i fushatave zgjedhore konsiston në mobilizimin e zgjedhësve, që mund të arrihet nëpërmjet mjeteve si: mbledhje e mendimeve politike, komunikim në lidhje me politikat, organizim aktiviteteve dhe mundësi pjesëmarrjeje, zhvillim anketash dhe peticionesh, komunikim në lidhje me politikat dhe me objektivat politik në rrjetet

sociale, nëpërmjet postës elektronike dhe tekst mesazheve telefonike, organizimi i aktiviteteve të nxitjes për të votuar ditën e zgjedhjeve etj. Këto qëllime dhe mjete duhen deklaruar në mënyrë sa më të plotë dhe të saktë që të jetë e mundur nga subjektet zgjedhore. Në kontekstin e fushatës zgjedhore, të dhënat personale të zgjedhësve në lidhje me mendimet politike nuk duhen përdorur për qëllime të tjera, të cilat tejkalojnë qëllimin për të cilin këto të dhëna janë mbledhur.

Mbrojtja e të dhënave personale, është një e drejtë kushtetuese e parashikuar në nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet se: *“Askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij. 2. Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj. 3. Kushdo ka të drejtë të njihet me të dhënat e mbledhura rreth tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj. 4. Kushdo ka të drejtë të kërkojë ndreqjen ose fshirjen e të dhënave të pavërteta ose të paplota ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin”*.

Në këtë kuptim, përpunimi i të dhënave personale të zgjedhësve, legjitimohet, kur kjo kryhet në dy mënyra: nëse zgjedhësi ka dhënë pëlqimin për përpunimin e të dhënave, ose në rastet e parashikuara me ligj.

Kur baza ligjore për përpunimin e të dhënave personale është pëlqimi, ai duhet të jetë i dhënë lirisht, për një qëllim specifik, i informuar dhe i qartë, duke pasur gjithashtu mundësinë e revokimit të tij në çdo moment. Kur subjektet zgjedhore mbështeten tek *“parashikimi ligjor”* për përpunimin e të dhënave personale, në çdo rast kjo arsye legjitime duhet t’u bëhet e ditur zgjedhësve.

Subjektet zgjedhore me kërkesën e tyre dhe pa pagesë, në bazë të nenit 60 të Kodit Zgjedhor, kanë të drejtë të marrin listat e zgjedhësve dhe ekstraktet e përbërësve zgjedhorë nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore përkatëse dhe/ose Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Gjithashtu ata mund të marrin nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile një kopje elektronike të listave të zgjedhësve, ose ekstraktit të përbërësve zgjedhorë në shkallë vendi, si dhe sa herë që ato përditësohen dhe publikohen. Kopja elektronike hartohet në mënyrë të tillë që të lejojë kërkitime dhe krahasime të kryqëzuara të të dhënave. Megjithatë, të dhënat e marra nga këto lista zyrtare të zgjedhësve nuk duhen kombinuar me burime të tjera të dhënash personale, me qëllim krijimin e profileve të zgjedhësve nëpërmjet shënjestrimit.

Vendosja në dispozicion e listave të zgjedhësve dhe ekstraktit të përbërësve zgjedhorë, ndaj subjekteve zgjedhore dhe publikut, duhet të realizohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit specifik si dhe duke garantuar zbatimin e parimeve të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, veçanërisht parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit.

Asnjë ndikim, apo presion i padrejtë nuk duhet ushtruar nga subjektet zgjedhore mbi zgjedhësit që të japin të dhënat personale. Kur bëhet fushatë fizikisht, derë më derë, përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore duhet të sigurohen se po mbledhin e përdorin të dhënat personale në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, duke qenë transparent për qëllimet për të cilat ata po mbledhin të dhëna personale si dhe të grumbullojnë vetëm të dhëna që janë të domosdoshme për përmbushjen e atyre qëllimeve. Ata nuk duhet të regjistrojnë asnjë informacion në lidhje me mendimet politike dhe/ose

preferencat politike të pjesëtarëve të familjes së zgjedhësve, përveç atyre që jepen me pëlqimin e vetë zgjedhësve. Në të kundërt, ekziston rreziku i profilizimit të një familjeje të tërë, bazuar tek vëzhgimi dhe mbledhja selektive e këtij informacioni.

Subjektet zgjedhore, shpesh mund të sigurojnë të dhëna personale të zgjedhësve nga palë të treta. Në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave, përpara se të përdoren këto të dhëna, subjektet zgjedhore duhet të verifikojnë nëse këto të dhëna janë përftuar në mënyrë të ligjshme, të informojnë zgjedhësit në lidhje me bazën ligjore dhe qëllimin e përpunimit të parashikuar.

Subjektet zgjedhore sigurohen që të dhënat personale të jenë të sakta dhe kur është e nevojshme edhe të përditësuara. Të dhënat personale të zgjedhësve nuk duhet t'i nënshtrohen përpunimit të mëtejshëm. Gjithashtu, ata nuk duhet t'i transferojnë ato të dhëna tek subjekte të tjerë, që kanë objektiva politikë apo këndvështrime ideologjike të ngjashme, pa pasur bazë ligjore apo pa marrë pëlqimin e qartë të zgjedhësit.

Nëse një zgjedhës ndjek një subjekt zgjedhor në një platformë sociale, kjo nuk do të thotë se subjekti zgjedhor mund të dalë në përfundimin se ai/ajo dëshiron komunikime nga kandidati, apo partia në fjalë. Në çdo rast, subjektet zgjedhore duhet të marrin paraprakisht pëlqimin e zgjedhësve në rast përpunimi të dhënash personale për këtë qëllim. Nuk mund të përdoren të dhëna nga platformat sociale për qëllime krijimi profilesh të elektoratit nga ana e subjekteve zgjedhore.

Nëse subjektet zgjedhore komunikojnë të dhëna personale me shoqëri të rrjeteve sociale për qëllime publiciteti digjital drejtuar grupeve të personave me mendime të ngjashme (p.sh. nëpërmjet instrumenteve të tilla sikurse *Facebook Lookalike Customized*

Audience), atëherë të dy këto subjekte marrin cilësinë e kontrolluesve të përbashkët të të dhënave personale. Asnjë e dhënë personale nuk i duhet komunikuar shoqërive të rrjeteve sociale për qëllime publiciteti digjital pa informuar paraprakisht subjektet e të dhënave sipas parashikimeve ligjore. Zgjedhësit duhen informuar në lidhje me të drejtën e tyre për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave për qëllime marketingu, e cila duhet të sjellë si pasojë fshirjen e pakthyeshme, apo heqjen e atyre kategorive të të dhënave personale të cilat janë kundërshtuar nga ana e tyre.

3.2 Përpunimi i të dhënave sensitive në lidhje me mendimet politike.

Kur përpunojnë të dhëna personale në lidhje me “*mendimet politike*” të zgjedhësve, subjektet zgjedhore duhet të kenë parasysh se ky lloj informacioni hyn në kategorinë e të dhënave sensitive, të cilat gëzojnë mbrojtje të veçantë nga legjislati kombëtar dhe ndërkombëtar i fushës.

Në kontekstin e fushatës zgjedhore, “*informacioni që zbulohet lidhur me mendimet politike*” ka rëndësi të veçantë. Subjektet zgjedhore mbledhin sasi të mëdha të dhënash personale që zbulojnë mendimet politike të tilla si, përkatësitë politike dhe anëtarësimin në një parti politike, historikun e votimit dhe/ose preferencat në lidhje me politikën, dhe më tej i përdorin këto të dhëna, për të profilizuar zgjedhësit lidhur me mendimet/qëndrimet e tyre. Rrjedhimisht, përpunimi i të dhënave personale që zbulojnë mendimet politike mbart rreziqe të rënda për zgjedhësit, që mund të rezultojnë në frikësimin e tyre, apo pengimin për të votuar.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, përpunimi i të dhënave që zbulon origjinën racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësinë në sindikata, besimin fetar apo filozofik, dënimet penale si dhe shëndetin dhe jetën seksuale, është i ndaluar. Ndërkohë në pikën 2, të kësaj dispozite parashikohen rastet përjashtimore kur mund të kryhet përpunimi i të dhënave sensitive.

Në kontekstin e këtij udhëzuesi, germa e), e pikës 2, të nenit 7 parashikon se: “Përpunimi i të dhënave sensitive bëhet vetëm nëse, të dhënat përpunohen nga organizatat jofitimprurëse politike, filozofike, fetare ose sindikaliste, për qëllime të veprimtarisë të tyre të ligjshme, vetëm për anëtarët, sponsorizuesit ose personat e tjerë, që kanë lidhje me veprimtarinë e tyre. Këto të dhëna nuk u bëhen të ditura një pale të tretë, pa pëlqimin e subjektit të të dhënave, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj”.

Gjithashtu, në legjislacionin ndërkombëtar të fushës së mbrojtjes së të dhënave personale, lidhur me sa më sipër, parashikohet se subjektet zgjedhore mund të legjitimohen të përpunojnë të dhëna personale për informacionin që zbulojnë, ndër të tjera, mendimet politike të zgjedhësve, vetëm nëse janë marrë masat e duhura mbrojtëse me qëllim parandalimin e riskut që buron nga përpunimi i të dhënave sensitive për interesat, të drejtat dhe liritë themelore të zgjedhësve, veçanërisht ndaj rrezikut për diskriminim.

Profilizimi i grupeve të zgjedhësve, bazuar në faktorë gjeografikë dhe/ose demografikë, mund të ketë pasoja diskriminuese, në të gjitha ato raste kur parashikimet në lidhje me grupe zgjedhësish, me karakteristika të përbashkëta, përdoren për të shënjestruar, apo për të veçuar zgjedhës të caktuar. Edhe në këtë rast, mbështetur në praktikën ndërkombëtare, rekomandohet që përpunimi i kategorive të veçanta të të dhënave personale, siç janë ato në lidhje me mendimin politik, duhet të shoqërohet

me masa të përshtatshme mbrojtjeje nga rreziqet e diskriminimit të zgjedhësve dhe të interesave, të drejtave dhe lirive të mbrojtura.

Nëse subjektet zgjedhore mbështeten tek pëlqimi, si bazë e ligjshme për të mbledhur të dhëna në lidhje me mendimet politike dhe për të dërguar mesazhe politike nëpërmjet komunikimeve me mjete të ndryshme, ata duhet të sigurohen që kanë marrë paraprakisht pëlqimin e zgjedhësve për këtë qëllim, duke u dhënë atyre mundësinë në çdo kohë që ta revokojnë atë. Në çdo rast, zgjedhësit informohen në lidhje me të drejtën e tyre për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave për qëllime marketingu të drejtpërdrejtë, e cila sjellë si pasojë fshirjen e të dhënave personale objekt kundërshtimi.

3.3 Siguria e të dhënave personale në kontekstin e fushatave zgjedhore

Gjatë periudhës intensive të fushatës zgjedhore, shpesh komunikohen të dhëna personale të zgjedhësve tek një numër i madh vullnetarësh dhe përpunuesish. Për këtë arsye, subjektet zgjedhore në cilësinë e kontrolluesit, duhet të marrin masa organizative dhe teknike të përshtatshme në lidhje me sigurinë e të dhënave, me qëllim mbrojtjen nga shkatërrimi aksidental, ose i paligjshëm, humbjen, ndryshimin, zbulimin e paautorizuar, ose aksesin e paautorizuar të të dhënave personale në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Rekomandohet që këto masa të jenë të përshtatura me karakteristikat e instrumenteve elektronike të përdorura (*telefon celular, kompjuter, internetin e objekteve (IOT), posta elektronike, biseda elektronike, etj.*) dhe të përfshijnë në to edhe trajnime të personave

përgjegjës (të autorizuar nga subjektet zgjedhore për përpunimin e të dhënave personale) në lidhje me privatësinë dhe sigurinë, kontrollin e aksesit, politikat e konfidencialitetit dhe kontrollet në lidhje me aksesin fizik në ambientet dhe pajisjet ku mbahen këto të dhëna.

Subjektet zgjedhore mund të kryejnë përpunime të dhënash për një numër të madh zgjedhësish në disa cikle zgjedhore. Zbatimi i masave të përshtatshme të sigurisë për këto të dhëna, është jetik për të garantuar që të dhënat e zgjedhësve të jenë të mbrojtura me standardet më të larta. Në këtë kuadër, është e nevojshme që masat e sigurisë të jenë në përputhje me standardet më të larta të sigurisë si dhe me praktikatat me të mira në fushën e përpunimit të të dhënave dhe në proporcion me seriozitetin dhe probabilitetin e rreziqeve të mundshme.

Për shkak të rëndësisë që paraqet marrja e masave të sigurisë së të dhënave, subjektet zgjedhore duhet të trajtojnë të gjithë personat që aktivizohen në fushatë politike, përfshirë punonjësit dhe vullnetarët e përkohshëm në lidhje me to.

3.4 Transparenca e përpunimit të të dhënave personale në kontekstin e fushatave zgjedhore

Përpunimi i të dhënave personale nga subjektet zgjedhore përgjatë kësaj periudhe, duhet të kryhet në mënyrë të drejtë dhe transparente, me qëllim garantimin e mbarëvajtjes së procesit zgjedhor duke evituar çdo mundësi komprometimi të tij.

Në momentin e mbledhjes së të dhënave, bazuar edhe në legjislacionin ndërkombëtar të fushës, është e nevojshme që subjektet zgjedhore të informojnë zgjedhësit (*nëpërmjet politikës së privatësisë apo një forme të ngjashme me të*) të paktën për: emrin, adresën e

subjektit zgjedhor, bazën ligjore për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale, periudhën e parashikuar të mbajtjes së të dhënave personale, kategorinë e të dhënave personale të përpunuara, çdo përftues/marrës të të dhënave dhe arsyet se përse u duhen komunikuar/transferuar palëve të treta (nëse është rasti), qëllimin e përpunimit, si edhe mënyrën se si zgjedhësit mund të ushtrojnë të drejtat e tyre.

Pavarësisht mënyrës së komunikimit të përdorur, përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore duhet të informojnë zgjedhësit se ata janë duke mbledhur të dhëna *“për llogari të X subjekti zgjedhor”*.

Politikat e privatësisë të subjekteve zgjedhore duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme, të lexueshme, të kuptueshme dhe të përshtatura për personat e interesuar. Në çdo komunikim që përdoret në fushatë zgjedhore, është e rëndësishme që vullnetari, apo punonjësi të prezantohet me anë të një teksti standard dhe të jetë i përgatitur për t’iu përgjigjur pyetjeve të zgjedhësve në lidhje me arsyet përse po mblidhet informacioni, si do të përdoret, kujt do t’i komunikohet dhe si mundet të heqë emrin e tij/saj nga këto lista. Teksti standard duhet të jetë gjithashtu i publikuar në faqen në internet të subjektit zgjedhor që po kryen fushatën.

Në rastet e marketingut të drejtpërdrejtë, subjektet zgjedhore duhet t’u bëjnë me dije zgjedhësve arsyen përse po u dërgohet ai komunikim si dhe kush është përgjegjës për këtë komunikim. Njëkohësisht subjektet zgjedhore duhet të informojnë zgjedhësit mbi të drejtën e tyre, për të mos qenë subjekt i këtij marketingu. Në kontekstin e përhapjes automatike të reklamave politike digjitale, zgjedhësit duhet të kenë të drejtën të dinë dhe të informohen për qëllimin se *“përse po e shohin atë reklamë”*.

4. TË DREJTATE ZGJEDHËSVE DHE DETYRIMET E SUBJEKTEVE ZGJEDHORE.

Referuar kontekstit të fushatës zgjedhore dhe kategorive të veçanta të të dhënave personale që përpunohen në kuadër të kësaj veprimtarie, ushtrimi i të drejtave të zgjedhësve në cilësinë e subjektit të të dhënave personale dhe zbatimi i detyrimeve që u ngarkohen subjekteve zgjedhore në cilësinë e kontrolluesve/përpunuesve të të dhënave personale, merr rëndësi të posaçme për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të tyre.

4.1 Të drejtat e zgjedhësve

Në rast përpunimi të të dhënave personale, zgjedhësit kanë të drejtën të informohen mbi mënyrën se si është përftuar informacioni i tyre personal dhe nga cili burim. Kjo është edhe më e rëndësishme nëse zgjedhësit kontaktohen nga subjekte zgjedhore me të cilët nuk kanë pasur më parë ndonjë marrëdhënie. Gjithashtu, në rast se synohet të përpunohen më tej të dhëna personale të zgjedhësve, për një qëllim të ndryshëm nga ai për të cilin ato janë mbledhur dhe ata nuk e kanë informacionin e duhur, zgjedhësit duhen informuar përpara përpunimit të mëtejshëm për këtë qëllim të ri përpunimi dhe çdo informacion shtesë të nevojshëm.

Zgjedhësit kanë të drejtën të informohen, me kërkesë dhe pa pagesë, nëse të dhënat e tyre personale po përpunohen si dhe të kenë akses tek këto të dhëna në një format të lexueshëm. Ata gjithashtu kanë të drejtën të kundërshtojnë përpunimin e të dhënave të tyre nga subjektet zgjedhore dhe sipas rastit të kërkojnë korrigjimin apo fshirjen në rast se të dhënat personale që lidhen me ta janë të pasakta, të papërditësuara apo jo të plota.

Zgjedhësit të cilët kundërshtojnë përpunimin e të dhënave për qëllime marketingu të drejtpërdrejtë, përfshirë edhe profilizimin, kanë të drejtën e fshirjes, apo heqjes së pakushtëzuar të të dhënave personale që janë objekt kundërshtimi, pa qenë të detyruar të tregojnë ndonjë arsye. Ata gëzojnë të drejtën të mos u nënshtrohen vendimeve që i prekin në mënyrë domethënëse, të cilat merren thjesht bazuar mbi një përpunim automatik të të dhënave, pa marrë parasysh mendimet e tyre.

Gjithashtu nëse pretendojnë se përpunimi i të dhënave të tyre personale kryhet në shkelje të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, ata kanë të drejtë të ankohen pranë Zyrës së Komisionerit.

4.2 Detyrimet e subjekteve zgjedhore

Detyrimi për të garantuar mbrojtjen e të dhënave personale dhe për të vërtetuar se përpunimi i tyre është në përputhje me legjislacionin e fushës, bie mbi subjektet zgjedhore.

Subjektet zgjedhore duhet të jenë në gjendje t'u komunikojnë informacion të plotë zgjedhësve mbi mënyrën se si janë përfutuar dhe përpunuar të dhënat personale, si dhe

të vërtetojnë se çdo palë e tretë që përpunon të dhëna personale për llogari të tyre garanton përdorim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave, vetëm në përputhje me udhëzimet e subjektit zgjedhor.

Subjektet zgjedhor duhet të ruajnë të dhënat personale të zgjedhëseve, vetëm për një periudhë kohore të përcaktuar në përputhje me qëllimin për të cilën janë mbledhur. Një detyrim i tillë vlen edhe për palët e treta të përfshira, të cilat gjithashtu duhet të marrin masa të përshtatshme në lidhje me kohën e ruajtjes si dhe shkatërrimin e tyre mbas përfundimit të qëllimit, në përputhje me udhëzimet e subjektit zgjedhor dhe legjislacionit specifik.

Vlen të theksohet se është e rëndësishme që subjektet zgjedhore të nxisin e të zbatojnë një kulturë gjithëpërfshirëse dhe përputhshmërie me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale në të gjitha nivelet, si përgjatë ashtu edhe ndërmjet cikleve elektorale. Për këtë arsye caktimi i personit të kontaktit/nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave, i cili/e cila verifikon dhe vërteton nëse janë respektuar parimet e mbrojtjes së të dhënave të subjektit zgjedhor ku bën pjesë, është një element thelbësor në këtë proces.

Vlerësimi i ndikimit tek mbrojtja e të dhënave, përpara nisjes së përpunimit, është një tjetër masë e nevojshme që sugjerohet të merret nga subjektet zgjedhore, kur për përpunimin përdoren teknologji të reja, ose nëse përpunimi paraqet rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e zgjedhësve për shkak të natyrës, shtrirjes ose objektivit të përpunimit. Subjektet zgjedhore në çdo rast duhet t'i dokumentojnë këto procese.

Bazuar në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar, por nisur edhe nga rastet e përhapjes së paligjshme të të dhënave personale të ndodhura, subjektet zgjedhore duhet

që të njoftojnë Zyrën e Komisionerit në rast cënimi, apo shkeljeje ndaj të dhënave personale gjatë fushatës zgjedhore Gjithashtu në rast se rreziku i shkaktuar nga cënimi, ka të ngjarë të jetë i lartë dhe konstatohet se masat teknike dhe organizative nuk ofrojnë siguri të mjaftueshme, rekomandohet që subjektet zgjedhore të njoftojnë edhe vetë zgjedhësit. Njoftimi duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm dhe të përshtatshëm për masat e ndërmarra për të zbutur pasojat negative të shkeljes së të dhënave.

Kur të dhënat përpunohen nga operatorë të tretë shërbimesh, subjektet zgjedhore duhet të jenë të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë e tyre të vazhdueshme si kontrollues të të dhënave. Ata duhet të jenë në gjendje të vërtetojnë se përpunuesit po respektojnë detyrimet e tyre në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.


Bazat e të dhënave të subjekteve zgjedhore duhet të aksesohen në mënyrë të kontrolluar nga çdo kategori punonjësish dhe vullnetarësh, apo çdo person tjetër, në mënyrë që të garantohet konfidencialiteti i tyre. Këto të dhëna duhet të përpunohen vetëm sipas udhëzimeve të subjekteve zgjedhor apo përpunuesve të caktuar prej tyre, të rregulluar me anë të një marrëveshjeje konfidencialiteti. Detyrimi për të mbajtur të dhënat konfidenciale vijon edhe përtej afatit të kësaj marrëveshjeje dhe marrëdhënies midis palëve.

* * *

Ky Udhëzues përmban orientime të përgjithshme dhe jo shteruese në lidhje me përpunimin e të dhënave personale në kuadër të fushatave zgjedhore si dhe masat e sigurisë që duhet të ndërmerret çdo subjekt zgjedhor për të garantuar përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave personale të zgjedhësve.

Mos zbatimi i këtyre detyrimeve përbën shkelje administrative dhe sanksionohet sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

**KOMISIONERI PËR
TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE**



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**